STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 12 dhjetor 2012

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) DERGON PERSONEL TE LARTE PER T'U DHENE PEME TE KRISHTLINDJES FAMILJEVE TE GODITURA RENDE NGA URAGANI SENDI (SANDY)

400 pemë dhurohen nga bujq të pemëve të Krishtilindjes në pjesën e sipërme të shtetit

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) dërgoi sot anëtarë të lartë të administratës së tij për të ndihmuar në shpërndarjen falas të 400 pemëve të Krishtlindjes për banorët në komunitetet e goditura rëndë nga Uragani Sendi (Sandy).

Anëtarë të Shoqatës së Bujqve të Pemëve të Krishtlindjes të Nju Jorkut (Christmas Tree Farmers Association of New York) (CTFANY), që përfaqëson afërsisht 400 nga 850 rritësit e pemëve të Shtetit të Nju Jorkut (New York), bënë dhurimet e pemëve. Pas shkatërrimit të shkaktuar nga Sendi (Sandy) në zonën me tre shtete, anëtarët e CTFANY u mobilizuan për të dhuruar pemë falas për viktimat e stuhisë. Pemët e dhuruara të bredhit dhe të pishës shiten me afërsisht 50 dollarë copa.

Duke punuar me organizatat e komunitetit dhe ato civile, vullnetarë të Departamenteve të Zjarrfikësave dhe një sindikatë vendore të punës, zyra e Guvernatorit kryesoi përpjekjet për të transportuar dhe për të shpërndarë pishat në komunitetet me nevojën më të madhe.

"Uragani Sendi (Sandy) shkatërroi komunitetet anembanë pjesës së poshtme të Nju Jorkut (New York) dhe për shumë familje kostot e shkaktuara nga stuhia kanë patur një pasojë të rëndë në buxhetet e tyre për sezonin e festave," tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). "Me shpërndarjen e disa qindra pemëve të Krishtlindjes jemi duke ndihmuar disa prej shumë familjeve të prekura që të kenë njëfarë gëzimi të festave pas këtyre javëve të vështira pas Sendit (Sandy). Në kohë vështirësie, banorët e Nju Jorkut (New Yorkers) janë gjithnjë të parët për t'u dhënë një dorë ndihme fqinjëve të tyre dhe falënderoj bujqit e pemëve të Krishtlindjes për dhurimin e tyre bujar."

"Bujqit e pemëve të Krishtilindjes të Nju Jorkut (New York) janë të gëzuar që po ndihmojnë fqinjët e tyre në pjesën e poshtme të shtetit," tha Meri Xhin Pekër (Mary Jeanne Packer), Drejtoresha Ekzekutive e grupit të bujqve të pemëve të Krishtlindje. "Anëtarët tanë dëshirojnë të ndihmojnë njerëzit që të kenë pak shkëlqim përsëri në jetën e tyre pas humbjeve të tmerrshme që përjetuan në stuhi. Asgjë tjetër nuk shpreh Krishtlindjen si një pemë e vërtetë," tha Pekër.

Ned Çepmën (Ned Chapman), pronar i Sanisajd Gardëns (Sunnyside Gardens) në Saratoga Springs (Saratoga Springs) ishte një nga bujqit e pemëve të Krishtlindjes që kontribuoi pemë për përpjekjen e ndihmës. Çepmën ishte i pranishëm në vendin e shpërndarjes në Stejtën Ajlënd (Staten Island) të mërkurën. Ai tha, "Pas gjithë asaj që kanë përjetuar këta njerëz, sjellja e disa pemëve të vërteta këtu që ata të gëzohen ishte më e pakta që mund të bënim."

Pemët erdhën nga mbi 25 ferma të pemëve të Krishtlindjes në pjesën e sipërme të shtetit në rajonet Bafallo (Buffalo), Roçester (Rochester), Sirakuzë (Syracuse), Allbëni (Albany) dhe Njubërg (Newburgh). Pemët u prenë të freskëta nga fermat fundjavën e kaluar dhe pastaj u ngarkuan në një kamion 53 këmbë të gjatë të hënën dhe të marten, i cili mbërriti në Long Ajlënd (Long Island) në agimin e të mërkurës. Pemët u dorëzuan gjatë gjithë ditës në vend në Qarkun Safolk (Suffolk County), Qarkun Naso (Nassau County), Stejtën Ajlënd (Staten Island), Bruklin (Brooklyn) dhe Kuins (Queens). Grupi 138 i Sindikatës Ndërkombëtare të Inxhinierëve të Funksionimit (International Union of Operating Engineers) ndihmoi në shpërndarjen e pemëve në Qarkun Safolk (Suffolk County). Pemët mbërritën në këto vende të mërkurën në mëngjes. Dy vendet e mëposhtme janë të hapura për shtypin:

11:00 paradite Komisionerja Arlen Gonzalez-Sançez, Komisionere, Zyra e Shërbimeve për Alkoolizmin dhe Abuzimin me Substancat e Shtetit të Nju Jorkut (New York State), bashkohet me zyrtarë vendas për të dhënë pemë të Krishtlindjes banorëve të prekur nga Uragani Sendi (Sandy)

Bay Park
Marjorie Lane
East Rockaway, New York
HAPUR PER SHTYPIN

1:45 pasdite Presidenti & CEO i Zhvillimit të Empire State Keneth Adams bashkohet me zyrtarë vendas për të dhënë pemë të Krishtlindjes banorëve të prekur nga Uragani Sendi (Sandy)

Stephen Siller Tunnels to Towers Foundation

2271 Hylan Blvd
Staten Island
HAPUR PER SHTYPIN

###